



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS



Nr. 402/01-47377, dt. 30.10.2020

Bazuar në nenin 11,12, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, neni 14.1, neni 17 pika c, dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, neni 34, pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 27 (E drejta e komunës për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga institucionet qendrore) të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Ligji Nr.06/L-092, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10. 2020, miraton këtë:

V E N D I M

Për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP. Drenicës, të cilat janë nën menaxhim të AKP-së, në zonën Kadastrale në Korroticë të Epërme.

Neni 1.

Vendimi për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP. Drenicës, të cilat janë nën menaxhim të AKP-së, në zonën Kadastrale në Korroticë të Epërme, si në vijim:

P-70314016-00026-0, tokë pyjore mal i klasës 3, me sipërfaqe prej 133374 m²,
P-70314016-00024-0, tokë bujqësore arë e klasës 5, me sipërfaqe prej 13583 m²,
P-70314016-00027-3, tokë bujqësore arë e klasës 6, me sipërfaqe prej 8355 m²,
P-70314016-00027-4, tokë bujqësore livadh i klasës 4, me sipërfaqe prej 68 m²,
P-70314016-00027-5, tokë bujqësore arë e klasës 6, me sipërfaqe prej 6011 m²,
P-70314016-00027-6, tokë bujqësore livadh i klasës 4, me sipërfaqe prej 27351 m²,
P-70314016-00027-7 tokë pyjore mal i klasës së 3, me sipërfaqe prej 19502 m²,
P-70314016-00040-1, tokë bujqësore arë e klasës 6, me sipërfaqe prej 4554 m²,
P-70314016-00249-2, tokë bujqësore arë e klasës 6, me sipërfaqe prej 1494 m²,
P-70314016-00249-3, tokë bujqësore arë e klasës 6, me sipërfaqe prej 36336 m².

Neni 2

Shpallja me Interes të Përgjithshëm Publik ka për qëllim bartjen e këtyre pronave në emër të Komunës së Drenasit, për realizimin e planit zhvillimor ekonomik, urbanistik dhe infrastrukturor të Komunës 2020-2028, konkretisht zgjerimit të zones ekonomike, të Parku i Biznesit.

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, për zbatimin e tij do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që konfrom dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës të vazhdojnë me procedurat për bartjen e këtyre pronave në emër të Komunës.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kopja e Planit dhe Çertifikatat e njësive kadastrale

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .

 **Kryesnesi i Kuvendit të Komunës**
Labinot Halilaj